

PËRPARIMI

Reviste kulturore

14400
182/62

NUMER 9

Shtator 1956

VJETI II

ANTARËT E REDAKSIS:

Imet Shagiri, Hizi Sulejmani, Vojisllaz Dugçetoriqi, Elhami Nimani,
Mehmet Hozha, Stathi Kostari, Abdullah Zajmi, Mehmedali Hozha, Lo-
renç Antoni, Mehdi Bardhi, Xheladin Topçiu, Ali Reza, Mark Krasniqi,
Jusuif Shushka, Hasan Vokshi, Imet Mula, Shevqet Veliu
Masur Murtezi

KËSHILLI REDAKTUES:

Stathi Kostari, Ali Reza, Xheladin Topçiu, Hasan Vokshi

DREJTORI PËRGJEGJËS

Elhami Nimani

REDAKTAJA:

ELEMENTET E SLLAVISHTËS SË JUGUT NË GJUHËN SHQIPE

Nga të gjitha valët e mëdha të shpërnguljeve që u derdhën prej veriut nëpër Gadishullin Ballkanik — më e reja, por edhe më madhja ishte ajo e dyndjeve *sllave*. Mbase qëndruen për do kohë në kufijt veriorë të Ballkanit — n'Alpe, Panoní, Dakí (Rumaní e soçme) — në shekullin e VI t'pokës sonë, Sllavët kapërcyen me forca të mëdha lumenjt e mëdhej Savë dhe Danub, që përbâjshin kufinin veriu të Perandoris Bizantine dhe shpërthyen si një shtërgatë e stërmadhe gadi nëpër mbarë Ballkanin; pothuaj gjith banorët e vjetër iu përkulën atij procesi — u mbajtën vetëm popullsít romanike t'Adriatikut dhe Grekët e brigjeve lindore, kurse në metropol, Shqiptarët dhe Rumunët; gjith Ballkani tjetër ra në durr të Sllavëve.

Sllavët e Jugut sod jetojnë vetëm në Jugosllaví dhe Bullgarí; por në kohën e shpërnguljeve i shofim edhe nëpër tanë Rumanín dhe Hungarín, në shum vise t'Austrís, në pjesën më të madhe të *Shqipnís*, në vise të ndryshme të Greqís dhe pjesërisht edhe n'Italín veriore. Ma vonë kolonít sllave u mbajtën vetëm në Jugosllaví dhe Bullgarí; por nga ana tjetër, në tanë vendet e dikurshme sllave të Ballkanit mbetën gjurma të shumta sllavizmi.

Kështu p. sh., përveç emnit *Beograd* në Sërbí dhe *Biograd* në Kroaci (Dallmatí) — po kët emën e gjejmë edhe në vende të ndryshme ballkanike, që sod nuk janë sllave, si dhe në krahina kufitare: Në Shqipnì *Berat* (prej emnit *Belgrad*; ky qytet në kohën e mesme quhet endë *Belgrad*, forma latinishte e të cilit është *Bellagradum*, greqishte *Velegradin*), në Rumaní *Bălgrad*, n'Italín veriore *Belgrado*, etj.

Një numër të madh emnash gjeografikë (tashq. *toponime*) origjine sllave gjejmë sod në Shqipnì, Greqí, Rumaní dhe Hungarí, dhe me shumicë edhe n'Austrí. Tue lanë më një anë vendet tjera, po merremi këtu me emnat gjeografikë sllavë të *Shqipnís*. Studimit të këtyneve i detyrohemi në mënyrë të veçantë të ndyerit sllavist sovjetik *A. M. Selishçevit*. Ai, mbase një studimi të hollsishtëm, përfundon se mund të flitet për dy

votra themelore sllave të jugut në truëllin e Shqipnís së soçme. Njana ishte në Shqipnín e veriut, gjatë rrugëve dhe rreth Shkodre. Këta ishin Sërbë, ose mâ saktisht e mâ mirë me thanë, kryekreje Malazezë. Votra tjetër ishte në Jug, në trevat e mëdha të Shqipnís jugore. Ndërmjet këtyne dy votrave shtrihet treva rreth lumit *Mati*, ku nuk ka gjurma emertimesh gjeografike, ose të paktën nuk ka aq shumë. Kur u shqiptarizuen mâ vonë këta Sllavë të Shqipnís, mbetën aty vetëm disa koloní të parandsishme: në jug rreth Korçë dhe në veri në qytetin e Shkodrës, por nga ana tjetër mbet një numër i madh emnash gjeografikë. Ne nuk mund t'i numrojmë këtu gjith ata emna; po shënojmë vetëm disa sish, në mënyrë që të shifet dendsija e përhapjes së tyne. Kështu, prej sllavishtes *gorica* („kodër, mal, pyll”) gjejmë në Shqipnín jo vetëm emnin e qytetit *Korçë*, por edhe emën në formën *Goricë* (shembuj të shumtë në vende të ndryshme), mandej *Gorë* dhe *Gorkë*. Gjithashtu maqedonishtes *Kruševo* dhe sërbishtes *Kruševac* (prej *kruš-k-a*, „dardhë — në Shqipnín i përgjigjen një numër i madh emnash: *Krushovë*, *Kroshovec*, *Krushevicë*, *Krushishtë*. Mandej prej sllavishtes *glava* — „kodër” në Shqipnín kemi *Gllavë*, *Gllavicë*, *Gjanicë* (kjo e fundit është e njëj forme mâ të vjetër), kështu edhe shumë tjera.

S'ka dyshim pra, se kontakti i ngushtë ndërmjet Sllavëve dhe Shqiptarëve në tokën shqiptare bani që Shqiptarët të shtijnë në gjuhën e tyne shumë elemente sllave¹⁾. Por kjo mund të ketë ndodhun edhe jashta periferís së Shqipnís së soçme. Si e kam përmendë dikur, kontakti i parë i Sllavëve të Jugut me Shqiptarët — në bazë t'atyne që din shkenca e soçme — ndodhi diku në periferí të Sërbís së soçme dhe të Maqedonís²⁾. Kjo don me thanë se elementet mâ të vjetra sllave kanë mundë me hy në gjuhën shqipe qysh n'atdheun e vjetër shqiptar në kohën kur Shqiptarët hala jetojshin në bashkí me Rumunë. Për këte kemi edhe shenime autentike, mbasi disa elemente shumë të vjetra sllave gjinden në të njëjtën formë edhe ndër Shqiptarë edhe ndër Rumunë. Shembull i këtij lloji është p. sh. fjala shqipe *daltë* = rum. *daltă*, që nuk rrjedh as prej sërbishtes *dleto* (*dlijeto*) as prej bullgarishtes *dljato*, por prej formës *dalto* ose *dlato*, e cila nuk egziston ndër Sllavët e soçëm të Jugut. Ngandojherë, një përkim i tillë i gjuhëve shqipe dhe rumanishte shtrihet edhe në gjuhën greqishte, dhe gjithkund gjejmë të njëjtën fjalë të vjetër sllavishte: p. sh. shqip

¹⁾ Problemin tjetër, çashtjen e elementeve shqipe në gjuhët sllave të jugut, do ta trajtoj një herë tjetër, në një punim të veçantë.

²⁾ Shiko artikullin tim — Marrëdhënjet ndërmjet gjuhës shqipe dhe rumune, — „Përparimi” I-6, fq. 353-358.

lëngë — „ultësinë” = rum. *luncă* = greq. e re *langá*, etj. Këtu nuk mund të hyjmë n'operacione të komplikueme për të vërtetue këto fakte, por po theksojmë se ka këso elementesh sllave, që janë të përbashkta për Shqiptarë e për Rumunë dhe që Shqiptarët, në bazë t'atyneve që u thanë, i muerën këto para shpërnguljes së tyre në Shqipni, që don me thanë sigurisht përnjiherë në shekujt e parë të shpërnguljes sllave në Ballkan. Edhe analiza e përgjithshme e vetinave karakteristike të këtyne fjalëve sllavishte në gjuhën shqipe — vërteton se kemi të bëmë afërsisht me të njajtën vjetërsi, si ajo e fjalëve sllavishte në gjuhën rumanishte, çashtje që është krejtsisht e logjikshme.

Kur u vendosën mandej Shqiptarët në Shqipni e soçme, vazhduen edhe me shti sllavizme në gjuhën e tyre, gjithsisht deri në kohën e shqiptarizimit të plotë të Sllavëve të hershëm të Shqipnis. Mâ në fund, randsija e shtetit serb dhe atij bullgar në Ballkan, veçanërisht randsija e Jugosllavis së soçme, banë që Shqiptarët edhe sod e kësaj dite të përvehtsojnë terma sllavishte, në rend të parë terma kulturore; (marrim p. sh. në Kosovë-Metohi shprehjet *stanicë-a*, prej sërbishtes *stanica*, ose *odbor*, e tjera si këto). Megjithatë, duhet ta themi se influenca sllave ndër Shqiptarë, megjithqë shumë e randsishme, përsëri është shumë mâ e vogël se influenca sllave ndër Rumunë. Në mënyrë të posaçme duhet të theksojmë se Rumunët muerën prej Sllavëve edhe besimin fetar edhe terminologjin fetare, gjâ që nuk ndodh ndër Shqiptarë. Numri i fjalëve sllavishte në gjuhën rumunishte kapet në mâ tepër se 3000, kurse ai i atyneve në shqipen (në bazë statistikash jo të plota) nuk e kapërcen mijën, don me thanë afërsisht sa janë edhe në gjuhën hungarishte, por nja dy herë mâ tepër se ka këso fjalësh greqishtja e re (Grekët, simbas statistikës së G. Meyer-it, kanë diçka mâ tepër se 400 fjalë sllavisht).

Kur flitet për fjalët sllavishte në gjuhën shqipe, del edhe çashtja e burimit të tyre mâ të ngushtë, ose mâ mirë me thanë prej cilës gjuhë sllave rrjedhin këto. Praktikisht, pyetet se a rrjedhin prej sërbo-kroatishes apo prej maqedonishtes, gjuhë këto që kanë qenë gjithnji në kufi të gjuhës shqipe. Marrë në përgjithsi, mund të thuehet se fjalët maqedonisht të marruna hua prej gjuhës shqipe janë të shumta, në krahasim me ato që janë marrë prej sërbishtes, nëqoftëse merren parasysht vetëm fjalët që kanë thjesht karakter populluer; por nëqoftëse llogariten edhe shprehjet që hyjnë në gjuhën shqipe ndikue prej pushtetit mbretner sërbe të kohës së mesme, atëherë mund të thuhet se edhe influenca sërbe është po aq e randsishme, e ndoshta edhe mâ e randsishme se ajo maqedhonase. Mjafton me përmendë se fjala shqipe *kral*, që (në fjalë të ndryshme) për-

doret me kuptimin („mbret i huej”, — rrjedh prej fjalës sërbishte *kralj*, mbasi Bullgarët, të cilët gjithashtu sunduen dikur Maqedhonin dhe Shqipërin nuk e përdorën këtë fjalë (Bullgarët përdorin vetëm fjalën *car*). Po kjo gjë ndodh edhe me shumë fjalë tjera, që si Selishçevi ashtu edhe shumë bullgarofilë tjerë, me qëllim nuk e kanë lanë mbas dorë ¹⁾).

Elementet sërbo-kroatishte, në disa rase, sa i përket kriterëve thjesht formale, pra kriterëve gjuhsore, mund të ndryshojnë. Kështu p. sh., në vend të „o-s” nazale sllave të vjetër, në shqipet gjejmë vokalin *u*; atëherë kjo tregon se fjala është origjine serbe. *Gusë* (edhe *gushë*) i përgjigjet sërbishtes *gus-ka* (forma familjare *gusa*), kurse maqedonisht thuhet *gaska* ose *goska*, që nuk mund të japi formën shqipe *gusë*. Po në këtë mënyrë edhe shqipja *drugë*, „furkë, shtijëzë” del prej sërbishtes *druga* dhe jo prej maqedonishtes *draga*. Gjithashtu edhe për shkak të skajesës „ek”, shqipja *purtekë*, *prutekë*, etj. nuk mund të nxirret prej formës maqedonishte, por prej sërbishtes *prutak*, ose më saktësisht prej malazishtes *prutek*; kështu vërtetohet edhe me sërbo. *i* (dhe jo *a*), në vend të nazales së vjetër *O*. Përkundrazi, ka gjithashtu edhe rase të qarta ku fjala shqipe origjine së vjetër sllave rrjedh prej një forme maqedonase dhe jo serbe. Kështu shqipja *grazh* (grasht) i përgjigjet maqedonishtes jugore *gražd* dhe bullgarishtes *gražd*, (krahaso rumanisht *grajd* = shqyrtohet *grazhd*). Po t’ishte kjo fjalë origjine serbe duhej të kërkojshim formën *gragj* (që nuk egziston). Po në këtë mënyrë edhe fjala *vazhdë*, *vazhdue* i përgjigjet sllavishtes së vjetër *v’azda*, maqedonishtes *važda*, bullgarishtes *vežda*, *vjažda* dhe jo sërbishtes *vedja*. Në rase tjera, gjithashtu, një ndryshim të tillë nuk është e mundur me vërtetë me anë analize, mbasi gjuha sërbo-kroatishte dhe maqedonishte janë origjine aq t’afërt, sa që nuk paraqesin asnjë ndryshim. Kështu p. sh., shqipja *domaqin* mund të nxirret njësoj si prej serbo. *domaćin* ashtu edhe prej maqedonishtes *dimak’in*, mbasi si në njërin ashtu edhe në tjetrën rase, për shqipen nxirret po ai rezultat. Nga ana tjetër, është e mundur me pasë edhe asi fjalësh që kanë hy edhe nga njëra edhe nga tjetra anë. Ka edhe kësi shembujsh që janë mjaft të qarta. Kështu p. sh., fjala e përhapur shqipe *opingë* rrjedh prej maqedonishtes *opinok*, (rum. *opancă*), kurse forma *opangë* e Shqipërisë veriore, vjen prej sërbishtes *opanak*.

Gjith këto që u thanë për „fjalët hua”, vlejnë edhe për emnat gjeografikë. Edhe aty kemi sërbizma e maqedonizma; por s’kemi nevojë të hyjmë këtu në hollësi, mbasi kjo gjë

¹⁾ Në studimin tim sërbo-kroatisht, — „Neki gentilni i njima srodni termini kod Crnogoraca i Arbanasa”, Sarajevo 1956, flas vetëm diçka pak.

i intereson më tepër sllavistikës se sa albanologjis. Po përmendim vetëm kaq, se në bazë të analizave të vetijave të shumta të emnave gjeografikë sllavë që gjinden nëpër Shqipëri mund të thuhet se Sërbët (Malazetët) dikur banuen pjesën veriore, kurse Maqedonët atë jugore të Shqipërisë.

Mbas këtyre shkoqitjeve parimore mund të hidhemi edhe në vetë landën e fjalorit të shqipes me origjinë sllave, për të shikuar ç'na paraqet ajo në lidhje me çashtjet kulturo-historike.

S'ka asnjëfarë dyshimi se Sllavët ndikuen me të madhe ndër Shqiptarë në fushë të agrikulturës (po kjo gjë konstatohet midis tjerash edhe sa u përket gjithë fqinjëve tjerë të Sllavëve të Jugut, veçanisht Rumunëve). Prandej Shqiptarët kanë për veditë terminologjinë e pasun bujqësore sllave¹⁾: *plug* (edhe variantet; fjala është sllavishte marrë nga gjermanishtja), *pluzhicë*, *jarm*, *oshte* (oishtejë, shtije — serb. *ojište*), *otkaç*, *lopar*, *leshë* (*lesë*), *vlač* (në rrethet e Shkodrës; *vlačiti*), *ostë* (-ni), *matukë*, *kopaç*, *kosë*, *koshëzë* (edhe *kostrë*) *kosis*, *bodec*, *vadis vlazhëtë*. Mandej: *vrah*, *lëndinë*, *sânë*, *kapicë*, *jarinë*, *plehe*, *plemë*, (maqedonisht *plemna*), *plevicë*, *kosh*, etj.

Po në këtë mënyrë edhe bimë të ndryshme që rrisin katu-ndarët, muerën emna sllave: *kastravec*, *llubenicë*, *repë*, *kopër*, *konop*, mandej edhe *pelint* (me gjithë variantet), *bozhur*, *bazilek* (me gjithë variantet), *lubenicë*, mbasandej emnat e disa drujve si *cimerikë*, *boranicë*, *vishnje* (*vishnja*), *belicë*, *borikë*, *topolë* (ndër Shqiptarët e Italisë), *gorricë*, e tjera.

Edhe terma të ndryshme që kanë të bëjnë me punë të fushës — kanë emna sllavisht: *brazdë* (*brazhdë*, *brazë*), *lehë*, *zagën*, *prashis*, etj.

Krahaso gjithashtu edhe *ograje*, *zabel*, *megje*, etj., përsëri prej sllavishtes.

Sa i përket blegtorisë, ndikimi sllav është shumë më i vogël. Kjo gjë spjegohet me faktin që Shqiptarët këtu e rruajtën gadi të paprekun terminologjinë e tyre vendase, terminologjinë e vjetër thrakase dhe përkundrazi këtu influencuen ndër Sllavë²⁾. Megjithatë, as në këtë lami nuk përjashtohet krejtësisht ndikimi sllav. Këtë e vërtetojnë për shembull fjalët *torishtë* (edhe *torrua*, etj), mandej *stan*, *kolibë* (e në sllavishte prej greqishtes), emni i djathit *travok* (ngjaj. *tvarog*), *rudë*, (për leshin), *skopit*; posaçërisht shpentarija dhe bletarija ka një shumicë termash sllavisht: *kokosh*, *kvaçkë*, *gusë* (*gushë*), *patë*, *patak* (*patok*, e

¹⁾ Megjithatë këtu ka mbetur edhe diçka trashëgim i vjetër thrakas por jo aq shumë. (Krahaso Elementet vendase në fjalorin e gjuhës shqipe, „Përparimi“ II/2, faqe 80). Kjo don me thanë se Sllavët vepruen këtu bartës formash të reja grikulturale.

²⁾ Krahaso art. tim Elem, vend faqe 79,80.

para prej serbishtes, e dyta prej maqedonishtes), *gullap*; *kosh*, *koshere* (për bletë), *krinë*, *voshtinë*, *matkë*, *rojis*, *rojke*, etj.

Terma sllave ka edhe në terminologjin peshkatore të Shqiptarëve: *belbicë*, *letnicë*, *pestrovë*, *krap* (Sllavët vetë e murën prej gjuës romanike), *ikra-të*; mandej *mrezhë*, *vlak* (lloj rrjete), *kosh* dhe mbas disave edhe *sule* (nëqoftëse rrjedh prej sllavishtes *čln*, sërb. *čun* „çamac”, çashtje që është e mundun, mbasi në vend të sllavishtes *č* kemi edhe në rasa tjera shqipe s).

Edhe në *zejtarin* shqiptare, ndikimi sllav është mjaft i randsishëm. Edhe këtu gjejmë një terminologji origjine sllave shumë të pasun:

valanicë (*vajanice*);

berdila — të (sërb. *brdila*), *drugë* (krahaso më sipër), *motovilë*, *kaç* (prej *tkač*);

teslicë, *topor*, *vitrë*, *kleçkë* (*qeçkë*), *kopan*;

kovaç, *patkua* (dhe shumë variante), *petë* (e kalit), *gozhdë*, *çekiç* (prej sërb. *čekić*), *verigë*, *toçilë*, *plloçë*, *plloçkë*, etj.

Asht me randsi me përmendë edhe terminin e përgjithshëm *orëndi* (= sllav. *orondije*, sërb. *orudje*).

Sendet e ndryshme të kulturës materiale, në shumë rasa, kanë gjithashtu emna sllavë:

Kafçek, *bravë* (?), *qyç* (*kluç*, ndër Shqiptarët e Italis *këjiç*), *verigë*, *kosh*, mandej posaçërisht bijnë në sy shumë emna enësh së ndryshme: *ponicë*, *vëshnik* (*vršnik*), *çerrep*, *gërçak* (dhe variantet e tij), *garraç* (dhe variantet), *kotel*, *vedër*, *kobel*, *kade*, *kac* (?), *kërbë*, *mesnik* (enë për mish), *kalanicë*, *bludë*, *pllockë* (*plloskë*), *çaçkë* (prej *čaša*; ndoshta origjine iraniane); *koritë*, *skrinjë*, *sitë*, *postaf*, etj. Këtu duhet të shtojmë edhe terminologjin zeytare që përmendëm.

Randsi të madhe ka mandej ndikimi sllav në arqitekturën shqiptare, ku gjithashtu gjejmë shumë terma sllavë: *strehë*, *postër* (prej *podstreha*), *podë* (s'është italishte, si mendohej dikur!), *trem* (Sllavët e kanë marrë prej greqishtes *zid*, *prak* (-gu), *grazhd* (krahaso më nalt, por jo edhe *gardh*, se *gardh* është fjalë e vjetër shqipe!), *policë*, *izbë* (në sllavishtet ka hy prej gjermanishtes), *glanik* (*gllanik*), *carâ*, (prej sll. *čejren-*), mandej *obor* *plemë*, *kotec*, *prese*, mbasandej edhe *stenë*, *stan(ë)*, *gradinë*¹⁾, e tjera.

Një numër sllavizmash shifet edhe në modë e në veshje: *postavë*, *rizë*, *kërpë*, *shapkë*, (si ndër maqedonas), *rub* (*maramë*), mandej — si përmendëm — *opengë* dhe *opingë*, më në fund edhe *oputë*; megjithatë shprehje kësodore këtu nuk ka kaq shumë. Krahaso edhe fjalën *penes* (-zi) — „pare që qepet si stoli

¹⁾ Në formën *gardinë*, që gjithashtu egziston, u përzie sllav. *gradina* me autoktonen *gardh* për arsye të kuptimit gjenetik.

në veshje e rrobe", marrë nga sërabishtja e vjetër *penez* (kurse kjo ardhun prej gjerm. *penning*, sod *Pfennig*).

Midis tjerash, të gjithë hulumtuesat theksojnë ndikimin e madh sllav ndër Shqiptarët edhe në jetën e tyre shoqnore në *rendin shoqnuer*, në *rendin shtetnuer*, *n'ushtri*, e tjera. Në këtë drejtim, ndikoi shumë ndër Shqiptarë edhe shteti feudal bullgar, por ndikimin më të madh e bani mbretëria feudale sërbe. Për këtë arsye edhe në këtë lami gjejmë shumë fjalë origjine sllave. — Para së gjithash — *bujar* (*bular*) dhe e kundërta *rop* e gjinija fem. *robinjë*, që në të vërtetë në kohët tona ka marrë deridiku një kuptim pak si të ndryshëm. Mandej fjala *kral* që përmendëm, edhe *knez*, (por zot është fjalë autoktone!). Edhe sa i përket kuptimit *pasuni* dhe së kundërtës së saj kemi disa shprehje sllave: *ndofta*, *bagëti*, (në fillim *pasunija* përgjithsisht, nëqoftëse vjen prej sllavishtes *bogat*), mandej *dobice* — (te Bogdani *dobitune* — „pobetiti”), *mbasandej* *poterë* dhe *sillë*, gjithashtu edhe *rëmbuem*, *rëmbim* (sll. e vjetër *rombiti*), *grabis*, *grabí*, *grabiç* — „razbojnik”.

Bashkë me këto kemi edhe pushtetin ushtarak dhe civil. Jo vetëm *kral* dhe *knez*, por edhe *voj(e)vodë*, *kaznec*, (që në kohën e mesme ishte funksionar i naltë i shtetit sërb), *çelnik*, mandej *straznik* dhe *strazhë*, *shtrazhë*, *pëndar* dhe *polak*; pastaj *krahinë*, *zakon*, *carinë*, *mitë*, *porez*, dhe *gjobë* (prej *globa* — fjalë shumë e lashtë, se u zhvillue në bazë rregullash specifike të shqipes; *krahaso* kosovarçen *gobë*), si edhe *dim* — „lloj porezi”, *voisht* (gjithashtu) edhe *bashtinë* — „pole”, me origjinë të terminologjis legjislaturore sllave (forma është bullgarishte). *Krahaso* mandej edhe *leçis*, *rënd*, *porosis* (= *poruçiti*), *zhdrivëllue* e tjera.

Kuptime të ndryshme zotnimi *pasunija* toksore, gjithashtu, kanë emna sllavishte, — p. sh. *bashtinë* — *a*, që përmendëm, mandej *potkë* dhe *megje*.

Familja dhe tjera bashkësi njerzore: *opçinë*, *domaqin*, *skotë*, *rod* dhe *rodnar*, *starisfat*, *dever*, mandej *gostis*, e tjera. Po në këtë mënyrë edhe profesione të ndryshme: *pëndar*, *kollar*, *kovaç*, *dërvar*, *kërçmar* *stajan* dhe *stajanice*, e tjera.

Edhe jeta psikologjike e Shqiptarëve u zhvillue deri diku nën njëfarë ndikimi sllav, çashtje që vërtetojnë shprehjet si *çudis*, *qudoj* (jo në lidhje me fjalën *čudo*, por me sërb. *ćud*), *koris*, *mërzis* (edhe *mërzí-ja*), *gërdis*, *habitem*, *shtravis* (pre-straviti) *reshis*, (*veselis*, *lubis*, *çenis*, (*ceniti*), *prevaris*, *nev(e)ris*, *shetis*, e tjera si këto; mandej *tugë*, *fale* „poklon” (edhe në shprehje).

Midis tjerash, ndikimi sllav nuk kufizohet vetëm në çashtje të shprehjeve e të kuptimeve kulturore, në një masë të madhe ai shtrihet edhe në fushat tjera. Në *topografi*, p. sh., kemi

rash, rapsh - „dolina” (simbas Jokl-it, dhe kjo në mënyrë bindse, prej sllav. *ravn-ica*), *llogë*, *rudinë*, *lëndinë*, *sop*, *stranicë*, *rros-poje*, *jerug* (*jaruga*) *borlok*, *brek*, *potog*, *rekë*, *galigë* (= *kalju-ga*), *llom*, *vrellë*, e tjera, por jo edhe në naltsinat malore.

Edhe pjesët e trupit të njeriut në disa rasa kanë emna sllave: *trup* (*turp*), *koc*, (*koskë*, *kockë*), *gërllac* (?), *grusht* (*krahaso* sërb. *pre-gršt*), *gërbë*; mandej vetit fizike: *memec* (*memec*), *skopaç*, e tjera. Diçka pak terma sllave ka edhe në çashtje të jetës seksuale edhe n'erotikë; këtu, duhet me dijtë se zotnon ndikimi tyrk, por si vërteton Jokl-i, janë të ruejtuna edhe shprehjet e lashta, thrakase.

Nga ana tjetër, kemi për shum dukuní të botës organike të natyrës — shum fjalë në botanikë e në zoologji.

Botanika: *rogos*, *rozgë*, *raqitë*, *zhabinë*, e tjera; këtu duhet me shtue edhe bimët e përmenduna kulturore edhe druajt (*shiqo* má nalt).

Zoologjija: Pos shtazëve shtëpijake të përmenduna, këtu po shtojmë edhe tjera: *zhabë*, *vidër*, *piavicë*, *karkalec*, *zhuzhinkë*, *musicë* (ndër Shqiptarët e Italis *mushiçë*), *moravicë*, *golash*, *ligavec*, *stenicë*, *mol-icë*, *sokol*, *vrapç* (dhe varijanta të ndryshme interesante), *galë*, *stërqok*, *kanjushë*, *meçkë*, *esh(es)*, mandej edhe emnat e ndryshëm për emnin *macë* (*maçe*, *macë*, kurse për gjinin mashkullore *maçok*, *maçor*, e tjera).

Këtu hyjnë edhe disa fenomene të natyrës: *zhek* (sërb. *žega*), *zagoren* (era e veriut), *jug*, *zhar*; mandej në lidhje me kohën *čas(t)*, (*mâ*) *pasdaj*, *rok*, e tjera.

Ma në fund deri edhe flajë sllavishte thjesht gramatike depërtuen e hynë në gjuhë shqipe, si p. sh. *okoll*, ndoshta edhe *opet* (*apet*).

Kaq për fjalët me origjinë sllave përgjithsisht.

Midis tjerash, Sllavët vepruen edhe si *ndërmjetës* ndërmjet Shqiptarëve dhe popujve tjerë, kështu që në gjuhën shqipe ka fjalë greqishte, hungarishte e gjermanishte, që kanë hy aty me ndërmjetsín e Sllavëve të Jugut. Për greqizma që kanë marrë Shqiptarët me ndërmjetsín e Sllavëve, veç është *bâ* fjalë ¹⁾; kështu kemi, p. sh., fjalët *praz*, *temel* (por jo edhe *themel* që është drejtpërdrejtë prej greqishtes), *pasul*, e tjera.

Ashtu si vërteton Jokl-i, gjindet një numër fjalësh hungarishte që janë përhapun shumë dhe kanë hy edhe në gjuhë shqipe, edhe këto gjithashtu me ndërmjetsín sërbe. Prej atyneve kulturore, má me randsí janë: *varosh* (prej sërb. *varoš*, marrë prej hungarishtes *város* — „qytet”) dhe *birov* (prej serb. *birov* e që rrjedh prej hung. *biró*), mandej *sobë* (hung. *szoba*),

¹⁾ Shiqo artikullin tim „Elementet e gjuhës greqishte në shqipe”, „Përparimi” II/5, faqe 301-302.

kuçi (te Bogdani) dhe disa fjalë tjera jo edhe aq të shumta. Asht interesant se Shqiptarët (të paktën te Bogdani) kanë marrë edhe formën *Beç*, t'emnit të kryeqytetit t'Austris, natyrisht prej formës sërbishte *Beç*, që është marrë prej tyrqishtes së vjetër); gjith popujt tjerë europianë përdorin formën gjermanishte *Wien*, — Italianët *Vienna*, frengjit *Vienne*, e tjera.

Këto që u thanë vlejné edhe për fjalët e marruna hua nga gjermanishtja, që gjithashtu nuk janë të shumta, por që prap-seprap ka; p. sh. *pushkë*, prej sërbishtes *puška* (dhe *puška*), marrë prej gjermanishtes së vjetër *buhša*; mandej *cehë*, *zehë* (serb. *ce-h*, prej gjerm. *zech*), dhe disa fjalë tjera. Këtu duhet të shtojmë edhe faktin që Sllavët e Jugut u dhanë hua Shqiptarëve edhe disa fjalë të vjetra, marrë qysh n'atdheun e tyre të lashtë (në Poloní) prej Gjermanëve, Iranasëve dhe popujve tjerë. Mirëpo, në lidhje me gjuhën shqipe, këto fjalë mund të merren si sllavishte, kështuqë nuk vlen me hy thellë këtu sa i përket kësaj çashtjeje.

Kaq edhe për çashtje të fjalorit përgjithsisht.

Ma në fund, mund të bájshim edhe një pyetje: a pati tjetër ndikim sllav përveç fjalorit? Në një pikëpamje të përgjithshme mund të themi se ka pasë; por, fatkeqsisht kjo çashtje deri sot është rahun shumë pak. Për këtë arsye duhet të knaqemi vetëm me disa vërejtje të pakta e të shkurta.

Para së gjithash, Shqiptarët „huajten” prej Sllavëve disa mbrapashtesa (sufikse) të të ndërtuemit të fjalëve. Tue përdorë këto mbrapashtesa në fillim *vetëm në fjalët sllavishte*, Shqiptarët e shtinë shkallë-shkallë këto edhe në fjalët e tyre. Kështu, sllavishtja — *nik*, në kuptime të ndryshme, tash përdoret për ndërtim fjalësh të reja *me rrâjë fjalësh autoktone shqipe*: p. sh. *besnik* me rrâjën shqipe *besë*, *fisnik* me rrâjën shqip *fis*, *drithnik* me rrâjën shqipe *drith* (kurse *mesnik* e ka edhe rrâjën edhe sufiksin sllav, ashtu si dhe në *vëshnik*).

Po në këtë mënyrë edhe mbrapashtesa sllavishte — *an*, prej së cilës del shqipja *-ân*, tash përdoret edhe ndër fjalët autoktone për të caktue mashkullin ndër shtazë, p. sh. *rikâ* — kundrejt shqipes femnore *rikë*, *shotâ* — kundrejt *shotë*; kjo vlen krejtsisht edhe për sufiksin — *icë*, që përcakton gjinin femnore: *gomaricë* — kundrejt *gomar* (që është fjalë greqishte), *bullicë* — kundrejt *bull* (origjinë latine), etj.

Ngandojherë Shqiptarët e përkthejnë me fjalët e tyre kuptimin e fjalëve sllavishte. Kështu, fjalët *dardhë*, *mollë*, etj. p. sh., tash kanë edhe kuptimin e „pemës” edhe ate të „drunit”, për arsye se në sllavishte *dardha* dhe *molla* i kanë të dy ato kuptime.

Asht e mundun që aty këtu të ketë ndikim sllav edhe në forma të fjalëve shqipe. Një gjâ e tillë ndodh qartas me

sufiksin — *O* në format *lalo* — „babë”, *mixho* — „axhë”, *vitc* — „pëllumb” dhe mandej *vasho* — vajzë”, e tjera. Unë konsideroj se kjo — *O* duhet prej vokativit sllav të tipit *Jovo!*, *Gjuro!*, *Stevo!*, etj., vetëm se Shqiptarët, tue mos e ndie kuptimin e kësaj mbrapashtese së huej, banë kësi *nominativash* dhe i shtinë edhe në gjinin *femnore* — (*vasho*). Këso procesesh edhe ka pasë në të vërtetë në qarkun e marrëdhanjeve të huashme të disa gjuhëve të Ballkanit; por edhe këtu nuk mund të hyjmë ma thellë.

Në sistemin nazal shqiptar pati me të vërtetë ndikim sllav, por edhe kjo nuk u studiue si duhet sod për sod, kështuqë edhe me kët çashtje nuk mund të merremi këtu.

Mâ në fund, me dashtë e me përmbledhë çashtjen e ndikimin sllav në gjuhën shqipe, mund të themi se ky ka qenë mjaft i madh, megjithqë jo aq sa ai i gjuhëve latine — romane e tyrqishte. Afërsisht, Grekët dhe Sllavët — përkah randsija — ndajnë vendin e tretë t'asaj treve ndërmyet tyne.

Dr. Ivan POPOVIQ